Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 21.3.1-2017-08

RAPORTI I AUDITIMIT

PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË TREGTISË DHE INDUSTRISË

PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017

Prishtinë, qershor 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Emine Fazliu, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Florim Maliqi (udhëheqës ekipi) dhe Qendresa Sogojeva e Lumturije Sopi, (anëtarë ekipi), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Samir Zymberi.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme....4

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit....6

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm....7

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli....10

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve....22

5 Qeverisja e mirë....23

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA....26

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme....29

Shtojca III: Letër konfirmimi....32

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (MTI) për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, për vitin 2017.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra e Kombëtare e Auditimit (ZKA) për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i MTI-së

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin dhe stafin e Ministrisë për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

Opinioni i Auditorit të Përgjithshëm

<u>Opinion i kualifikuar me Theksim të Çështjes</u>

Sipas mendimit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore 2017 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* të gjitha aspektet materiale, përveç çështjes së paraqitjes së huamarrjes në buxhetin fillestar dhe final te neni 14, e të cilat nuk do të duhej të paraqiteshin.

<u>Theksimi i çështjes</u>

Ne tërheqim vëmendjen për faktin se në vitin 2017, nuk ishin prezentuar detyrimet kontigjente në shumë prej 1,932,830€.

Për më gjerësisht shih pjesën 2.1 të këtij raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore

Kualifikimi i Opinionit dhe Theksimi i Çështjes pasqyron dobësitë në përgatitjen e PVF-ve dhe kontrolleve për të sigurar prezantim të saktë/drejtë të PFV-ve.	Ministri duhet t'i analizojë arsyet për Kualifikim të Opinionit dhe Theksim të Çështjes dhe t'i identifikojë veprimet që kërkohen për të sigurar se PVF-të e ardhshme përgatiten si duhet përfshirë prezantimet dhe shpalosjet e nevojshme, të sakta dhe të verteta. (shih kapitullin 2.1).
Planifikimi dhe ekzekutimi i buxhetit për kategorit ekonomike nuk ka qenë në nivelin e duhur.	Ministri duhet të siguroj planifikim adekuat të buxhetit dhe në bazë të një analize të hollesishme nga zyrtarët e ministrisë (shih nënkapitullin 3.1)
Planifikimi i të hyrave është i dobët dhe ka nevojë për rregullativë të qartë të brendshme që përfshinë të gjitha llojet e të hyrave	Ministri duhet të siguroj planifikimin e duhur për të gjitha llojet e të hyrave, si dhe të siguroj rregullore të brendshme të qartë për të hyra (shih nënkapitullin 3.1.1)
Ministria ka dobësi në menaxhimin e disa fushave: personelin, investimet, mallrat dhe shërbimet, subvencionet dhe transferet si dhe llogaritë e arkëtueshme	Ministri duhet të siguroj menaxhim dhe kontrolle adekuate për kategoritë e përcjellura me dobësi, veprimet për evitimin e dobësive të merren në një përiudhë të shkurt kohore.(shih nënkapitullin 3.2-3.6)
Qeverisja në MTI në lidhje me raportimin menaxherial dhe llogaridhënien, pasqyron një situatë pozitive. Aktiviteti i Auditimit të Brendshëm i mbështetë zhvillimet në këtë fushë. Mirëpo ka nevojë ende të përmirësohet kjo fushë.	Ministri duhet të ndërmerr veprime për identifikimin e të gjitha rreziqeve dhe të siguroj sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit në përkrahjen e objektivave të organizatës. Po ashtu të sigurohet se njsitë e audituara përgatisin planet e veprimit dhe zbatojnë rekomandimet e NjAB-së. (shih kapitullin 5)

Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2017

Ministri është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e MTI-së. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Ministrisë se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e AP-së.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i Kualifikuar me Theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, përveç çështjes së përshkruar në paragrafin për bazën për opinion të kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren e MF nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar të Organizatave Buxhetore.

Baza për opinion të kualifikuar

Te neni 14 - Raporti i ekzekutimit të buxhetit – pjesa e hyrjes së parasë së gatshme në llogari të Thesarit është paraqitur buxheti fillestar nga Huamarrjet prej 492,000€ dhe buxheti final prej 192,000€. Financimi nga huamarrja për pranimet nuk duhet të prezantohet në PVF individuale. Kjo ka rezultuar në gabim material në Pasqyrat Vjetore Financiare dhe për këtë arsye ne kemi kualifikuar opinionin tonë.

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave vjetore financiare të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga Ministria dhe përgjegjësitë tjera etike janë përmbushur në pajtim me

këto kërkesa. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se ministria kishte detyrime kontingjente në shumë prej 1,932,830€ të cilat nuk janë prezantuar në PFV te neni 18. Lista e detyrimeve kontigjente ishte bashkëngjitur PFV-ve me rastin e dorëzimit të tyre në Thesar-Ministrinë e Financave. Përveç këtyre, në të dhënat e Avokaturës Shtetërore janë 31 lëndë/raste tjera për të cilat ministria nuk ka shpalosur informata në PFV, dhe nuk ishte në dijeni për këto raste. Këto çështje nuk modifikojnë opinionin por ndikojnë në Theksimin e Çështjes.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Sekretari i Përgjithshëm i MTI-së është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrolle të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Nga MTI kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. nr.01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime);
- Pajtueshmërinë me rregullat financiare nr.01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve; dhe
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK).

Deklarata e bërë nga menaxhmenti i MTI-së

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në MF nuk mund të konsiderohet e saktë, pasi ekzistojnë gabime që kanë ndikuar në kualifikimin e opinionit të auditimit.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Rekomandimi 1 Ministri duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për kualifikimin e opionionit. Përgatitja e PFV-ve duhet t'i nënshtrohet kontrolleve dhe rishikimit të duhur më qëllim që të mos përsëritën gabimet në prezantimin e huamarrjeve.

Rekomandimi 2 Ministri duhet të analizoj shkaqet e theksimit të çështjes dhe të sigurojë se detyrimet kontingjente trajtohen dhe analizohen me kujdes dhe në koordinim më Avokaturën Shtetërore të sigurohen informata/dëshmi për përfaqësim adekuat të këtyre rasteve/lendeve. Po ashtu duhet siguruar informata dhe shpalosje të mjaftueshme për detyrimet kontigjente në PFV.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh kyçe në sistemet financiare, megjithatë në disa fusha të shpenzimeve kërkohet përmirësim i mëtejshëm i kontrolleve në mënyrë që të sigurohet menaxhim efektiv nga MTI.

Fushat kryesore ku nevojiten përmirësime të mëtejme janë planifikimi dhe realizimi i buxhetit në investime dhe mallra e shërbime, menaxhimi i personelit, fusha/proceset e prokurimit, obligimet dhe llogaritë e arketueshme.

Mangësitë në menaxhimin financiar dhe kontrollet janë reflektuar dhe potencuar edhe në procesin/dokumentin e vet-vlerësimit të dorëzuar në Ministrinë e Financave.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final[1]	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Burimet e Fondeve:	**7,966,392**	**5,946,124**	**4,925,978**	**4,557,724**	**4,731,018**
Granti i Qeverisë -Buxheti	7,474,568	5,754,300	4,925,978	4,557,199	4,730,493
Financim nga huamarrjet	491,824[2]	191,824	0	0	0
Donacionet e jashtme	0	0	0	525	525

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar është zvogëluar për 2,020,268€. Këto ndryshime janë bërë në bazë të buxhetit të rishikuar dhe vendimeve të qeverisë në fund të vitit.

Të[1] Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

[2] Në PFV është theksuar se marrëveshja për huamarrje e nënshkruar nga MF dhe Banka Botërore nuk ishte ratifikuar në Kuvend të Kosovës dhe financimi i projekteve të parapara me huamarrje nuk ishte realizuar.

Në vitin 2017, ministria ka shpenzuar 83% të buxhetit final apo 4,925,978€, krahasuar me vitin e kaluar kemi një ulje të realizimit të buxhetit për 15% (2016 - 98%). Dukuri negative është kryerja e pagesave në fund vit, ku rreth 79% të shpenzimeve kapitale kanë ndodhur në tremujorin e fundit 2017.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	**7,966,392**	**5,946,124**	**4,925,978**	**4,557,724**	**4,731,018**
Pagat dhe Mëditjet	1,510,347	1,418,344	1,399,399	1,402,343	1,313,025
Mallrat dhe Shërbimet	2,236,589	1,760,743	935,457	1,198,814	1,432,027
Shërbimet komunale	109,280	105,880	65,166	55,794	84,516
Subvencionet dhe Transferet	1,558,176	1,558,176	1,475,695	1,274,893	1,106,535
Investimet Kapitale	2,552,000	1,102,981	1,050,261	625,880	794,915

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Buxheti final për kategorinë e pagave dhe mëditjeve është zvogëluar për 92,003€, me rishikim të buxhetit për 11,999€ dhe me vendime të Qeverisë 80,004€. Ky zvogëlim ishte rezultat i mos plotësimit të shtatë pozitave të lejuara, zgjatjes se procedurave të rekrutimit dhe pushimeve pa pagesë;
- Për kategorinë e mallrave dhe shërbime është zvogëluar buxheti për 475,846€. Si rezultat i rishikimit të buxhetit 300,000€ dhe me vendime të Qeverisë 175,846€. Pavarësisht kësaj, ministria ka pasur dobësi në rrjedhën e parasë, pasi brenda vitit rreth 15 herë kishte bërë ndryshime në rrjedhën e parasë së gatshme duke bërë alokime të parakohshme, bartje të mjeteve nga një program në program tjetër. Problem tjetër ishte planifikimi i aktiviteteve me kosto me të lartë se sa realizimi etj;
- Buxheti final në raport me buxhetin fillesar për shërbimet komunale me vendim të Qeverisë ishte zvogëluar për 3,400€, përkundër zvogëlimit realizimi i buxhetit ishte 62%;
- Buxheti final për subvencionet dhe transferet nuk kishte ndryshim nga ai fillestar, realizimi ishte 95%; dhe
- Buxheti final për shpenzime kapitale krahasuar me atë fillestar është zvogëluar për 1,449,019€ me vendimin e Qeverisë nr. 08/151, pasi ministria nuk ka arritur të realizoj të gjitha projektet e planifikuara. Buxheti i shpenzuar për këtë kategori është 95%.

Çështja 3 – Dobësi në realizimin e buxhetit

E gjetura	Në përgjithësi buxheti i shpenzuar për vitin 2017 nuk ishte në nivelin e pritur apo 83%. Arsyet e realizimit të ulët kryesisht ndërlidhen me planifikim të dobët. Programi për Investime Publike në vitin 2017përfshinë 12 projekte prej të cilave katër projekte nuk janë zbatuar, kjo për shkak të mungesës së menaxhimit të duhur për fillimin e ekzekutimit të projekteve. Ekzekutimi i ulët është edhe në kategorinë mallra dhe shërbime si dhe shpenzimet komunale që ishte 53% përkatësisht 62%. Kjo ka ndodhur pasi planifikimi i shpenzimeve nga njësitë kërkuese ishte bërë me kosto me të lartë se sa realizimi.
Rreziku	Planifikimi jo i duhur i buxhetit dhe realizimi jo në nivelin e pritur mund të rezultojë në përformancë të dobët dhe mos arritjen e objektivave të ministrisë.
Rekomandimi 3	Ministri duhet të siguroj menaxhim të mirë të buxhetit vjetor dhe të bëjë vlerësime sistematike të arsyeve lidhur me nivelin e ulët të ekzekutimit të buxhetit për projekte që ndërlidhen me investimet kapitale, mallra dhe shërbime si dhe komunalit në mënyrë që të përmirësoj përformanca.

3.2 Te hyrat

MTI për vitin 2017 ka planifikuar të hyra në vlerë prej 1,554,569€, ndërsa ka realizuar 1,854,733€ (120% e planit). Krahasuar me vitin paraprak (2016) kemi ulje të të hyrave për 433,080€ apo 19%.

Tabela 1. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Pranimet	2016 Pranimet	2015 Pranimet
Të hyrat vetjake	1,554,569	1,554,569	1,854,733	2,287,813	1,887,894
Të hyrat totale	**1,554,569**	**1,554,569**	**1,854,733**	**2,287,813**	**1,887,894**

Burimet kryesore të të hyrave të MTI-së janë të hyrat nga regjistrimi i pengut, të hyrat nga licenca për shërbime profesionale, të hyrat nga shfrytëzimi i pronës publike, etj.

Çështja 4 – Planifikimi dhe menaxhimi i të hyrave

E gjetura

Ministria ka rreth 18 lloje të të hyrave. Tarifat dhe procedurat janë të rregulluara përmes udhëzimeve administrative të veçantë për secilin departament që inkason të hyra. Mirëpo, ministria nuk ka një rregullore të brendshme për të gjitha të hyrat vetjake e cila do ti përfshinte tarifat për secilën lloj të hyre të gjeneruar nga MTI.

Planifikimi i të hyrave nga MTI ishte i dobët. MTI planifikon të hyra në bazë të departamenteve dhe jo sipas llojeve të të hyrave.

Rreziku

Mungesa e unifikimit/konsolidimit të rregullores në nivel të ministrisë vështirëson kontrollin dhe menaxhimin e të hyrave. Ndërsa planifikimi jo adekuat mund të rezultojë me dobësi në kontrollin dhe monitorimin e përformancës se të hyrave.

Rekomandimi 4

Ministri duhet të siguroj menaxhim të mirë të të hyrave, bazë të qartë të unifikuar/konsoliduar rregullative për të hyrat e ministrisë dhe me rastin e planifikimit të merren parasysh të gjitha aspektet duke përfshirë llojet adekuate të të hyrave.

3.3 Pagat dhe shtesat

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga MAP dhe MF. Megjithatë janë një sërë kontrollesh të cilat operojnë në kuadër të MTI-së, e të cilat ndërlidhen me autorizimin e listës së pagave, verifikimin e ndryshimeve, rishikimin e buxhetit për këtë kategori, barazimet me thesarin etj. Prandaj është e rëndësishme që të ketë kontrolle efektive për të siguruar se këto veprime janë në përputhje me rregullat e përgjithshme.

Shpenzimet për paga dhe mëditje për vitin 2017 ishin 1,399,399€ apo 99% e buxhetit për këtë kategori. Auditimi ynë ka shpalosur çështjet në vijim:

Çështja 5 – Ushtrues detyre më shumë se tre muaj dhe dobësi në kompensimin e stafit

E gjetura

Sipas nenit 30 të LSHC "Në rast të mbetjes së një pozite të lirë në shërbimin civil, ushtruesi i detyrës nuk mund të emërohet më gjatë se tre muaj". Ne kemi vërejtur se 11 pozita që janë drejtor dhe udhëheqës të sektorëve, që janë mbuluar për më shumë se tre muaj (12 deri 18 muaj) me ushtrues detyre. Prej tyre në gjashtë raste është bërë rotacion/ndërrim në mes të zyrtarëve çdo tre muaj. Në këtë situatë ka ndikuar edhe nga fakti se tetë zyrtarë janë pezulluar nga puna dhe janë ende në procese gjyqësore.

Më tej një numër i zyrtarëve për pozita të njëjta ishin kompensuar me koeficientë të ndryshëm (jo në pajtim me akt emërimet), pozitat janë: asistent administrativë, zyrtar të lartë, udhëheqës i sektorit, udhëheqës i drejtoratit, drejtor i drejtoratit etj..

Këto çështje janë identifikuar/trajtuar edhe në raportin e auditimit të vitit 2016 dhe lidhur me këtë ministria ka bërë kërkesa (në MF dhe MAP) për buxhet shtesë për harmonizim të pozitave dhe koeficienteve, mirëpo nuk është arritur të përmirësohet gjendja.

Rreziku

Mbajtja e pozitave udhëheqëse me ushtrues detyre për më shumë se tre muaj dhe aplikimi i koeficienteve të ndryshëm për pozita të njëjta mund të ketë efekt negativ në marrjen e përgjegjësive dhe llogaridhënies në punë, gjë që do të ndikoj në performancën dhe arritjen e objektivave të organizatës në përgjithësi.

Rekomandimi 5

Ministri duhet të sigurojë menaxhim dhe kontrolle adekuate në fushën e personelit, të ndërmarrë veprimet që për pozitat e mbuluara me ushtrues detyre të bëhet zgjidhje e qëndrueshme me pozita të rregullta në pajtim me kërkesat ligjore dhe kompensimi i zyrtarëve të bëhet në harmoni me përshkrimin e detyrave të punës.

3.4 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2017 ishte 1,760,743€, prej tyre ishin shpenzuar 935,457€ apo rreth 53% nga buxheti i ndarë për këtë kategori. Ndërsa buxheti final për shërbime komunale ishte 105,880€ i cili ishte realizuar në masën 62%. Nga auditimi ynë identifikuam çështjet si në vijim:

Çështja 6 - Anashkalimi i procedurave të prokurimit

E gjetura Sipas LPP nr. 4/L-042, blerjet/shërbimet duhet ti nënshtrohen procedurave të këtij ligji, më përjashtim të nenit 3 ku blerjet e caktuara përjashtohen nga procedurat e prokurimit. Mirëpo ky nen nuk përjashton shërbimet kontraktuese, që në rastin e MTI-së është për sallën për organizime. Ministria kishte paguar 5,000€ për organizimin e gala mbrëmjes për projektin "Made in Kosova". Ky shërbim nuk i është nënshtruar procedurave të ofertimit dhe kontraktimit të rregullt.

Rreziku Shërbimet e pranuara të cilat nuk ishin nënshtruar procedurave të prokurimit ka si pasojë eliminimin e konkurrencës, mungesën e transparencës së procesit dhe mos arritjes së vlerës për para.

Rekomandimi 6 Ministri duhet të sigurojë kontrolle adekuate në procesin e shpenzimeve dhe zbatim korrekt të procedurave të blerjeve (LPP), më qëllim të rritjes së transparencës mbi shpenzimin e parave publike.

Çështja 7 - Kontrata për shërbime të veçanta më gjatë se gjashtë muaj

E gjetura Sipas neni 12 të LSHC nr.03/L-149, organizata buxhetore mund të angazhojnë punëtorë me afat të caktuar për më pak se gjashtë muaj. Ministria kishte angazhuar 20 punëtorë me marrëveshje për shërbime të veçanta (MSHV). Prej tyre 12 janë angazhuar më tepër se gjashtë muaj (8 deri 25 muaj), po ashtu angazhimi i tyre ndërlidhet me programet e përhershme të punës si zyrtar për markat tregtare, zyrtar i prokurimit, ekspert i meteorologjisë, mbikëqyrës i projekteve kapitale.

Rreziku Angazhimi i stafit me MSHV për më shumë se gjashtë muaj dhe për pozita të përhershme, rezulton me performancë dhe monitorim të dobët të stafit dhe cilësia e shërbimeve të ofruara nuk mund të jetë e nivelit të duhur për arritjen e objektivave të organizatës.

Rekomandimi 7 Ministri duhet të siguroj kontrolle në angazhimet e stafit me kontrata për shërbime të veçanta që ato mos të kalojnë periudhën e lejuar. Nevoja për staf shtesë për pozitat e karrierës duhet të analizohet dhe nëse rritja e numrit të stafit është e domosdoshme, kjo të inkorporohet në planifikimet buxhetore.

Çështja 8 – Avancet/paraja e imët e pambyllur

E gjetura

Sipas procedurës të avanceve për paranë e imët avancet duhet të mbyllen dhe arsyetohen në fund të vitit dhe në fillim të vitit vijues. Ne kemi identifikuar se tre avance për paranë e imët, janë arsyetuar/mbyllur në vitin vijues me tre muaj vonesë. Ndërsa një rast në vlerë 2,500€, kishte 17 muaj vonesë, ishte hapur në janar 2016 dhe ishte mbyllur në maj 2018.

Ndërsa avancat për udhëtime zyrtare sipas nenit 8 të UA 2004/07, duhet të mbyllen 15 ditë pas përfundimit të udhëtimit zyrtarë. Ministria ende nuk ka arritur të mbyll avancin për udhëtime zyrtare nga kabineti i ministrit, i hapur në shkurt 2016 në vlerë 1,500€[3].

Rreziku

Vonesat në mbylljen e avanceve mund të rrezikojnë që paratë e shpenzuara mos të arsyetohen, dhe të mos përdoren për objektivat/qëllimet e ministrisë.

Rekomandimi 8

Ministri duhet të sigurojë menaxhim të mirë dhe kontrolle adekuate rreth avanceve, të respektohen afatet ligjore për mbylljen e tyre, ndërsa mjetet e pa arsyetuara duhet të kthehen në buxhetin e ministrisë sipas kërkesave ligjore.

[3] Për një pjesë të këtyre mjeteve MTI ka kërkuar nga Avokati Shtetëror për të nisur procedurë gjyqësore ndaj ish zyrtarit të MTI (shoferi ish zv. Ministrit) për kthimin e mjeteve.

3.5 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 1,558,176€, prej tyre ishin shpenzuar 1,475,695€ apo 95%. Pjesa më e madhe (68%) e këtyre shpenzimeve janë për Fondin për Garanci Bankare të Kosovës. Ndërsa shpenzimet tjera kryesisht janë për pagesën e hapësirave në panaire ndërkombëtare për promovimin e produkteve vendore dhe rritjen e mundësive për eksport.

Çështja 9 – Dobësi në dhënien dhe monitorimin e subvencioneve

E gjetura

Me nenin 4 dhe 10 të UA 03/2016 për ndarjen e subvencioneve nga MTI, përcaktohen kriteret dhe rregullat për dhënien e subvencioneve nga ministria, ndër tjera koston financiare dhe planin kohor të realizimit të projektit.

Me datë 16.08.2018 është bërë pagesa në vlerë 120,000€ në llogari të UNDP[4]-së për projektin "Ndihmë Tregtisë", e cila ka rrjedhur nga marrëveshja e datës 14.09.2016 dhe e rishikuar me 15.08.2017. Për këtë pagesë UNDP nuk ka sjellë plan financiar dhe kohor për përfundimin e projektit. Po ashtu, nuk janë sjellë kontratat e bëra me këto mjete dhe në përgjithësi mungonte një raport mbi shpenzimet e mjeteve në kuadër të këtij projekti. Gjatë auditimit tonë është siguruar kontrata për promovimin e investimeve në vlerë 30,000€, ndërsa për vlerën e tjetër prej 90,000€ nuk kishte të dhëna/informata për planifikim apo realizim të këtyre shpenzimeve dhe nëse janë arritur rezultatet.

Rreziku

Ekzekutimi i pagesave pa plotësuar kriteret për dhënien e subvencioneve dhe anashkalimi i procedurave të përcaktuar në rregullore mund të ndikoj që mjetet e ministrisë të mos përdoren në mënyrë ekonomike dhe transparente dhe mund të ndikojnë në efektivitetin e menaxhimit të subvencioneve.

Rekomandimi 9

Ministri duhet të sigurojë kontrolle adekuate në fushën e subvencioneve duke respektuar marrëveshjet dhe kërkesat ligjore me qëllim që objektivat e projektit të jenë të qarta dhe realizimi i subvencioneve të sjell rezultatet e planifikuara.

[4] United Nations Development Program-Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara

3.6 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 1,102,981€. Prej tyre ishin shpenzuar 1,050,261€. Çështjet e ndërlidhura me këtë kategori janë ngritur në kapitullin vijues çështjet e përbashkëta mallra shërbime dhe investime kapitale, nuk kemi ndonjë çështje tjetër.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime me këtë fushë.

3.7 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet Kapitale

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale:

Çështja 10 - Dobësi në prokurim

E gjetura

Gjatë testimeve tona kemi vërejtur këto dobësi në planifikim dhe në zhvillim të procedurave të prokurimit:

- Në mungesë të planifikimit sipas nevojave reale, ministria nga 56 kontrata të nënshkruar gjatë viti 2017, 26 prej tyre apo 46% janë me vlerë minimale. Për më tepër, në tri raste kemi identifikuar se janë përsëritur kontratat për blerjet e ngjashme. Për furnizime me pajisje të teknologjisë informative (TI), janë zhvilluar tri procedura, për shpërndarjen e materialeve promovuese dhe furnizim me inventar janë zhvilluar nga dy procedura. Përsëritjes së kontratave i ka kontribuar edhe mos arritja e nënshkrimit të kontratave nga AQP[5] për pajisje të TI dhe inventar.

- Sipas nenit 81 të LPP, autoritetet kontraktuese janë të obliguara për përgatitjen e planit për menaxhim të kontratës. Me rastin e testimit të procedurave të prokurimit në nëntë raste është vërejtur proces i dobët në mbikëqyrje të projekteve. Organi mbikëqyrës i projekteve nuk ka plotësuar planin detal për menaxhimin e kontratës më informata e nevojshme.

[5] Autoriteti Qendror i Prokurimit

- Sipas nenit 41.2, të rregullave dhe udhëzuesit operativ të prokurimit publik, procedurat për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve do të kryhet nga autoriteti kontraktues brenda periudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave dhe vetëm për kontrata komplekse mund të zgjatet me afat shtesë prej 20 ditësh. Ne kemi identifikuar se për vlerësimin e tenderit për "Mirëmbajtje e Parkut të Biznesit në Drenas", procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin të tenderit ka zgjatur 50 dite apo 20 ditë më shumë se koha e lejuar.

Rreziku Numri i lartë i procedurave të prokurimit në vlerë minimale dhe përsëritja e kontratave të ngjashme rezulton me planifikim jo real dhe kosto shtesë në zyrën e prokurimit, si dhe ndikon në eliminimin e konkurrencës. Mos përpilimi/përgatitja e planit të menaxhimit të kontratës, rrezikon që devijimet e mundshme të mos identifikohen si dhe mos respektimi i afateve kohore në vlerësimin e ofertave paraqet kontrolle të dobëta në këtë fushë.

Rekomandimi 10 Ministri duhet të siguroj menaxhim të mirë dhe kontrolle adekuate në fushën e prokurimit, njësitë kërkuese të jenë të qarta në përcaktimin e nevojave dhe përgatitja e planit të prokurimit të jetë sa më real. Të siguroj se janë zbatuar të gjitha kërkesa ligjore gjatë vlerësimit të ofertave dhe zbatimit të kontratave, me qëllim të rritjes së vlerës për paranë publike.

Çështja 11 - Mungesa e lejes ndërtimore dhe shpenzimet për pranim teknik të objektit

E gjetura Sipas nenit 14 të ligjit nr. 04/L-110 për ndërtim, leja ndërtimore kërkohet për ndërtime të reja, rindërtime, rrenim, riparim të objekteve dhe intervenim në fasada/strukturë të objekteve. Ndërsa për të gjitha objektet që kërkohet leja ndërtimore pas përfundimit të punëve merret edhe certifikata e përdorimit e cila lëshohet nga organi kompetent[6], i cili lëshon lejen e ndërtimit. Për marrjen e certifikatës së përdorimit nuk parashihet të bëhet pagesë. Inspekcioni ndërtimor ka të drejtë të bëjë inspektimin final të vend ndërtimit dhe poseduesi i lejes ndërtimore duhet t'i siguroj qasje të arsyeshme në vend ndërtim.

Për projektin "Ndërtimi i mbikalimit për këmbësor dhe dy bus stacioneve përballë Parkut të Biznesit Drenas", vlera 109,264€ (kontrata bazë 99,741€ dhe ankes kontrata prej 9,523€), ministria nuk është pajisur me leje ndërtimore. Procesi/procedurat e ndërtimit kanë filluar vetëm në bazë të pëlqimit të marrë nga Ministria e Infrastrukturës. Ndërsa përkundër mungesës së lejes ndërtimore ministria ka kontraktuar një operator ekonomik për të bërë pranimin teknik të projektit dhe për këtë ka paguar 8,150€, pa bazë/kërkesë të qartë rregullative/ligjore. Raporti i pranimit teknik është bërë me 18.12.2017.

[6] Organet kompetente për lëshimin e lejeve ndërtimore dhe të certifikatës së përdorimit/pranimit teknik, janë Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Komunat

Më këtë rast, në mungesë të lejes ndërtimore ministria ka shkaktuar paqartësi rreth pranimit teknik dhe pajisjes me certifikatë të përdorimit për ndërtimin në fjalë.

Rreziku Mungesa e lejes ndërtimore nuk është shembull i mirë dhe mund t'a ekspozoj ministrinë para rreziqeve nga inspektorati i ndërtimit. Ndërsa shpenzimet për pranimin teknik rezultojnë në mos justifikimin e duhur të parasë publike.

Rekomandimi 11 Ministri duhet të siguroj se trajtohet mungesa e lejes ndërtimore dhe në koordinim dhe bashkëpunim me organet kompetente të marrë veprime për çështjen e lejes së përdorimit dhe të sigurohet se të gjitha shpenzimet e bëra justifikohen dhe kanë mbështetje ligjore.

3.8 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Për vitin 2017, vlera e pasurive të ministrisë mbi 1,000€ ishte 14,367,000€, pasuritë jo kapitale nën 1,000€ janë 156,000€ si dhe stoqet në fund të vitit 2017 janë 20,000€. Gjatë vitit 2017, ministria ka bërë një progres të dukshëm në aspektin e regjistrimit të pasurive në krahasim me vitin paraprak.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime me këtë fushë.

3.9 Të arkëtueshmet

Sipas shënimeve të prezantuara në PFV shuma totale e llogarive të arkëtueshme në fund të vitit 2017 ishte 180,000€ deri sa në vitin paraprak ishin 202,000€.

Çështja 12 - Mos aplikimi i interesit për vonesat e pagesës së qirasë

E gjetura Nenit 2.5 i kontratës mbi qiradhënien me bizneset që operojnë në Parkun e Biznesit në Drenas, përcakton që në rast të mos pagesës me kohë të qirasë brenda 15 dite të çdo muaji, të aplikohet 5% interes mujor. Në 11 raste kishte vonesa në pagesë, të cilat ishin prej pesë muaj deri në 12 muaj. Mirëpo ministria me rastin e faturimit kishte kalkuluar vetëm borxhin mujor prej 7,478€, e jo edhe interesin mujor i përllogaritur prej 373€. Ne kemi vërejtur se në përgjithësi interesi nuk është zbatuar as për llogaritë e arkëtueshme të mëhershme nga qiraja. Vlera e tyre e bartur nga viti 2010-2017 ka arritur në 168,490€, ndërsa vetëm në vitin 2017 janë krijuar 69,827€.

Rreziku Mungesa e një strategjie për inkasimin e të hyrave ka rezultuar me rritjen e llogarive të arkëtueshme ndërsa mos aplikimi i kushteve të kontratës/interesit mund të sjellë humbje financiare për ministrinë dhe nuk stimulon bizneset të paguajnë borxhet e tyre.

Rekomandimi 12 Ministri duhet të ketë një strategji në menaxhimin e kontratave të qirasë dhe trajtimin e llogarive të arkëtueshme si dhe të aplikoj mekanizma më efektiv për uljen e llogarive të arkëtueshme.

3.10 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnizuesve në fund të vitit 2017 ishte 42,074€, të cilat janë bartur për pagesë në vitin 2018. Në vitin 2016 obligimet ishin 30,000€, vërehet një rritje prej 12,074€. MTI ka shpalosur edhe një listë me detyrime kontigjente prej 1,932,830€, dhe 31 raste tjera janë në listat e Avokaturës Shtetërore. Çështjet lidhur me detyrimet kontigjente i kemi paraqitur në kapitullin 2.1 të këtij raporti (opinioni i auditimit).

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime me këtë fushë.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2016 ka rezultuar në pesë rekomandime. Ministria kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Si pjesë e auditimit tonë, në vitin 2017 kemi vlerësuar se nga rekomandimet e dhëna për vitin 2016, një rekomandim është zbatuar, dy pjesërisht dhe dy nuk janë zbatuar. Ndërsa nga katër rekomandimet e vitit 2015, një është zbatuar, një në proces të zbatimit dhe dy prej tyre vazhdojnë të mos zbatohen. Më në detaje janë paraqitur në shtojcën II.

Çështja 13 – Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak dhe viti i mëhershëm

E gjetura	Rekomandimet të cilat nuk janë zbatuar ndërlidhen më çështjet si: pagat dhe mëditjet sipas përshkrimit të punës dhe mbulimi i pozitave udhëheqëse me ushtrues detyre.
Rreziku	Mos adresimi i plotë i rekomandimeve të dhëna shton rrezikun që të vazhdoj përsëritja e dobësive të njëjta në sistemet kryesore të MTI-se.
Rekomandimi 13	Ministri duhet të sigurojë kontrolle dhe monitorim adekuat të planit mbi zbatimin e rekomandimeve, të identifikohen shkaqet e mos zbatimit të rekomandimeve dhe të ndërmirren veprime për rishikimin e planit i cili i nënshtrohet monitorimit të rregulltë nga menaxhmenti.

5 Qeverisja e mirë

Hyrje

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

MTI ka bërë një numër përmirësimesh në qeverisje, por ende mbesin një numër fushash ku nevojiten zhvillime të rëndësishme. Me theks te veçantë janë planifikimi dhe realizimi i projekteve kapitale, çështjet tjera lidhur me pagat dhe mëditjet si dhe çështjet lidhur me të hyrat dhe menaxhimin e llogarive të arketueshme.

5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me dy anëtarë të stafit - Drejtori i NjAB dhe një auditor, të cilët janë të licencuar. Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) ka realizuar planin e auditimit, me pesë auditime të rregullta dhe një me kërkesë të menaxhmentit. Megjithatë kjo njësi është përcjellë me këto dobësi:

Çështja 14 – Funksionimi jo i mirë i NjAB

Rreziku Sipas doracakut për auditimit të brendshëm-shablloni nr. 23, kërkon nga menaxhmenti (njësia e audituar e organizatës) përgatitjen e planit për implementimin e rekomandimeve të NJAB. Gjatë vitit 2017 menaxhmenti nuk kishte përgatitur asnjë plan për implementimin e rekomandimeve.

Neni 7 i udhëzimit administrativ nr. 11/2010 për themelimin dhe funksionimin e komitetit të auditimit, përcakton raportimet e komitetit të auditimit. Për vitin 2017 komiteti i auditimit nuk ka përgatitur raportin vjetor për menaxhmentin.

Rreziku Mos përgatitja e planeve për implementimin e rekomandimeve nuk kontribuojnë në përmirësimin e dobësive të organizatës dhe rrezikon që dobësitë e evidentuara të përsëriten. Mungesa e raportimeve nga komiteti i auditimit nuk i ofron siguri menaxhmentit mbi punën dhe mbikëqyrjen e NjAB.

Rekomandimi 14 Ministri duhet të siguroj funksionim të duhur të NjAB-së, për rekomandimet e dhëna të përgatiten planet për implementimin dhe gjithashtu të siguroj se komiteti i auditimit ka përmbushur kërkesat për mbikëqyrje dhe raportim.

5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Procesi i raportimit të brendshëm në MTI funksionon sipas zingjirit llogaridhënës, sipas ligjit dhe strukturës organizative. Në kuadër të ministrisë funksionojnë shtatë[7] agjencione ekzekutive të cilat kanë strukturën e vet menaxheriale, përmes të cilës organizohet menaxhimi i aktiviteteve të përditshme operative. Ato kryejnë aktivitete operative të natyrave specifike për të cilat i raportojnë drejtë për drejtë Ministrit. Ndërsa pasqyrat financiare përgatiten në MTI edhe për agjencionet.

Po ashtu, në kuadër të MTI-së funksionojnë edhe 10 departamente, ku drejtorët e këtyre departamentve raportojnë tek Sekretari i Përgjithshëm, këto takime janë të rregullta javore dhe trajtohen të gjitha aktivitetet e tyre.

[7] Agjencia për Investime dhe Përkrahjet Ndërmarrjeve në Kosovë (AIPNK), Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve (ARBK), Agjencia e Pronësisë Industriale (API), Agjencia e Metrologjisë së Kosovës (AMK), Agjencia Kosovare e Standardizimit (AKS) dhe Drejtoria e Akreditimit të Kosovës DAK.

Çështja 15 – Proceset e menaxhimit të rrezikut

E gjetura Ministria gjatë vitit 2017 nuk kishte arritur që të ushtroj mjaftueshëm kontrollet menaxheriale. Ne kemi identifikuar dobësitë në vijim:

- Sipas rregullave të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK), MTI duhet të ketë një regjistër të rreziqeve. MTI kishte hartuar regjistrin e rreziqeve mirëpo nuk kishte përgatitur një raport për veprimet e ndërmarra ndaj rreziqeve në kuadër të organizatës.
- Sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2010, neni 2, subjektet të cilat merren me importim, deponimin, shitjen me shumicë dhe pakicë të naftës dhe derivateve të saj në Kosovë janë të obliguar të licencohen. Ne kemi vërejtur se jo të gjithë bizneset janë pajisur me licencë shërbimi. Sipas zyrtareve të ministrisë në pjesën veriore të Kosovës, janë rreth 37 biznese që nuk kanë licencë shërbimi; dhe
- Ministria gjatë vitit kishte shpallur 24 konkurse, 13 të jashtme dhe 11 të brendshëm, mirëpo 14 prej tyre ishin anuluar nga mungesa e numrit të kandidatëve të suksesshëm apo konkurrentëve.

Rreziku Mungesa e menaxhimit efektiv dhe gjithë përfshirës të rrezikut do të dobësojë cilësinë e shërbimit ndaj qytetarëve. Mungesa e një strategjie për licencimin e të gjitha bizneseve të cilat operojnë në Kosovë paraqet sfide për ministrinë në të ardhmen. Po ashtu numri i lartë i konkurseve të anuluara, paraqet në menaxhim jo të duhur të këtij procesi.

Rekomandimi 15 Ministri duhet të sigurojë se është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut. Gjithashtu të siguroj se të gjitha bizneset të cilat operojnë në territorin e Kosovës kane licencë shërbimi dhe të analizoj arsyet e anulimeve të shumta të konkurseve duke ndërmarrë veprime përmirësuese.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinioni mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç 'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
2.5.1 Vlerësimi i rrezikut	Ministrja duhet të sigurojë se është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut tek një drejtor përkatës dhe të sigurojë raportim mujor për zbatimin e kërkesave në këtë fushë dhe për rreziqet që janë duke u menaxhuar. Më tutje, krahas regjistrit të rreziqeve duhet të përpiloj edhe planin aksional për monitorimin e gjasës së ndodhjes së atyre rreziqeve dhe ndërmarrjen e masave për ti sjell në kufirin e pranueshëm. Kjo do të evitonte pengesat potenciale në arritjen e objektivave të ministrisë.		Pjesërisht është zbatuar pasi plani aksional për monitorim te rreziqeve nuk është përgatitur.	
2.5.1 Vlerësimi i rrezikut	Ministrja duhet të sigurojë se do të bëhet një rishikim I proceseve për menaxhimin e personelit dhe sistematizimin e të punësuarve sipas përvojave adekuate për të siguruar respektimin e rregullave në fuqi dhe përfitimin më të mirë nga kapacitet ekzistuese njerëzore në kuadër të MTI-së.			Nuk është zbatuar
3.5.2 Kompensimet (paga dhe mëditje)	Ministrja duhet të sigurojë se të gjitha pagesat për paga dhe mëditje bëhen në përputhje me përshkrimin e detyrave të punës dhe për përfituesit e fondit të kuadrove të aplikojë rregulloren në fuqi. Po ashtu duhet të siguroj se numri dhe shpërndarja e të punësuarve brenda departamenteve të organizatës është në përputhje me Ligjin e buxhetit.			Nuk është zbatuar

3.8.1 Pasuritë kapitale dhe jokapitale	Ministrja duhet të sigurojë se janë ndërmarrë hapa konkretë për sigurimin e një depoje dhe për përgatitjen e raportit të inventarizimit me kohë në mënyrë që të ketë kontrolle adekuate rreth pasurisë së MTI-së.	Është zbatuar		
Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
1.2Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim	Ministrja duhet të siguroj se janë marrë masat dhe veprimet e nevojshme për të përmirësuar gabimet e identifikuara në theksimin e çështjes. Në këtë aspekt, projektet të cilat janë në vijimësi duhet të regjistrohen si investime në vijim, dhe pas finalizimit të projekteve të bëhet bartja e pronësisë sipas marrëveshjeve të nënshkruara.	Është zbatuar		
2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	Ministri duhet të sigurojë që plani i veprimit, duhet të rishikohet duke analizuar shkaqet e rekomandimeve të pazbatuara, dhe të përcaktojë një afat të ri kohor për zbatimin e rekomandimeve, përfshirë edhe stafin llogaridhënës. Në fokus fillestar duhet të jenë fushat e një rëndësie më të madhe. Implementimi i këtij plani duhet të monitorohet në vazhdimësi.		Pjesërisht	
3.1.2 Pagat dhe mëditjet	Ministrja duhet të sigurojë që numri dhe shpërndarja e stafit brenda institucionit është në përputhje me limitet e lejuara sipas programeve të parapara me Ligjin e Buxhetit. Po ashtu të siguroje se pagesa e zyrtarëve bëhet sipas përshkrimit të detyrave të punës.			Nuk është zbatuar

3.1.2 Pagat dhe mëditjet	Ministrja duhet të ndërmerr veprime për të ndërprerë praktikat e mbulimit të pozitave me U.D, si dhe të iniciohen procedurat e rekrutimit në mënyrë që këto pozita të plotësohen me kontrata të rregullta sipas afatit të përcaktuar ligjor.			Nuk është zbatuar
3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Ministrja duhet të sigurojë që brenda një periudhe sa më të shkurtër kohore të rekrutojë Zyrtari i Pasurisë, si dhe të sigurojë se komisionet e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurisë, të përfundojnë punën e tyre dhe raportojnë me kohë në mënyrë që vlera e pasqyruar në PFV të jetë e plotë dhe e saktë.		Është zbatuar por, disa pagesa kane mbetur te pa regjistruar ne pasurit jo kapitale nen 1,000€	

Shtojca III: Letër konfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE
27. 06. 2018
Njësia Org. Org. Jedin. Org. Unit: 03
Shif.Klasif. Klasif. Kod Class. Code: 47
Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.: 1192
Nr.i faqeve Br. Stranica No. Pages: 1

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRISË - MINISTARSTVO TRGOVINE I INDUSTRIJE - MINISTRY OF TRADE AND INDUSTRY
Njësia Org. Org.Jedinica Org.Unit: 01
Nr.Prot: Broj Prot: Prot No.: 4439
Nr.i faqeve Broj stranica No.pages: 01
Data. Datum. Date: 27.06.2018
Prishtinë / a

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Ministarstvo Trgovine i Industrije-Ministry of Trade and Industry

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2017 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të **Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë**, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 (në tekstin e mëtejmë "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Bajram Hasani.....

Ministër – Ministria e Tregtisë dhe Industrisë,

Data: 27 Qershor 2018, Prishtinë,